

DEKLARATË

Ndërveprimi i KQZ-së me Institucionet e Drejtësisë, hap tejet pozitiv për funksionalitetin e ligjit ndaj shkeljeve dhe krimeve zgjedhore për Zgjedhjet Parlamentare të 11 Majit 2025

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) përshëndet dhe mbështet hapat e ndërmarrë së fundmi nga Institucionet e Drejtësisë, si Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), si dhe Policia e Shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), **për rritjen e vëmendjes dhe bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe forcimin e masave kundër krimeve zgjedhore**¹, në vigjilje të zgjedhjeve të 11 majit 2025.

Ngritja e grupeve të posaçme në prokuroritë vendore dhe krijimi i një strukture të veçantë në kuadër të SPAK për hetimin e veprave penale në zgjedhje **konsiderohen hapa thelbësorë në luftën kundër deformimit të vullnetit të qytetarëve dhe për forcimin e demokracisë në vend**. Këta hapa, në gjykimin e KRIIK, janë një pasqyrim i qartë i një vullneti institucional për të parandaluar dhe ndëshkuar krimet zgjedhore.

Në mënyrë të veçantë, KRIIK vlerëson hapat e ndërmarrë nga këto struktura² për të bashkëpunuar ngushtë dhe në mënyrë proaktive për monitorimin, parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve zgjedhore.

Takimet e fundit mes Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve z. Celibashi me Drejtuesin e SPAK z. Dumani³ dhe Prokurorin e Përgjithshëm z. Çela⁴, si dhe takimi i Prokurorit të Përgjithshëm me Drejtuesin e Policisë së Shtetit z. Proda⁵, nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit mes institucioneve, dhe të tjera veprimtari që kanë në thelb koordinimin dhe bashkëveprimin, **janë shenja pozitive për një angazhim institucional serioz, ligjor e të koordinuar**.

¹ Veprat penale që lidhen me procesin zgjedhor parashikohen në Kreun X të [Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë](#), pjesë e cila u ndryshua me [ndryshimet e miratuara](#) në dhjetor të vitit 2020. Gjithashtu [ligji nr. 148/2020](#) përcaktoi detyrimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, t'i japin KQZ-së informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, që nuk cenon ruajtjen e sekretit hetimor sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Penale. Veprat penale që lidhen me korrupsionin aktiv dhe pasiv në zgjedhje u bënë objekt hetimi nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK.

² - [Udhëzimi i Përgjithshëm](#) nr. 2 datë 18.02.2025 i Prokurorit të Përgjithshëm "Për masat administrative dhe procedurale nga prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhjeve".

- Në datën 29.01.2025 Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, [SPAK miratoi një plan masash](#) mbi "Zbatimin e Strategjisë së Hetimit dhe Parandalimit të Krimit Zgjedhor gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin 2025" në kuadër të hetimit dhe parandalimit të krimeve zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025.

³ [Takimi](#) i datës 13.02.2025 midis Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Drejtuesit të SPAK, lidhur me forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për parandalimin e krimeve zgjedhore dhe hetimin proaktiv të veprave penale në zgjedhje.

⁴ [Takimi](#) i datës 11.02.2025 midis Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Prokurorit të Përgjithshëm mbi forcimin e bashkëpunimit për integritetin e procesit zgjedhor.

⁵ [Takimi](#) i datës 5.02.2025 midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, lidhur me bashkëpunimin dhe koordinimin mes prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Policisë së Shtetit në kuadër të hetimit të krimeve zgjedhore.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

KRIIK ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme **nevojën për një angazhim të fortë dhe të pavarur të Institucioneve të Pavarurara dhe në veçanti për një ndërveprim institucional mes KQZ-së dhe Institucioneve të Drejtësisë** jo vetëm për parandalimin e ndëshkimit e praktikave të paligjshme në fushën e zgjedhjeve⁶, por veçanërisht për t'i dhënë fund fenomenit të pandëshkueshmërisë që buron nga pushteti politik apo çdo lloj pushteti tjetër që shkel apo sfidon ligjin.

Vetëm një ndërveprim efektiv ndër-institucional mund të adresojë ndëshkimitin përmbajtësisht të fenomeneve negative që çënojnë prej dekadash integritetin e zgjedhjeve në vend, të tilla si: blerja e votës, presioni mbi administratën publike apo prej kësaj të fundit ndaj zgjedhësve, keqpërdorimi i burimeve shtetërore, mungesa e transparencës dhe kontrollit ndaj financimit politik, shkeljet prej administratës zgjedhore e partive politike, etj., **fenomene këto që dëmtojnë thelbësisht besimin e qytetarëve në sistemin demokratik** dhe bien ndesh me standardet e një shoqërie të lirë e të një shteti ligjor funksional.

KRIIK, në vijim të angazhimit të pandërprerë të tij për adresimin e këtyre fenomeneve dhe monitorimin e procesit zgjedhor, si dhe të mbështetjes në mirëfunksionimin e KQZ-së e të Institucioneve ligjzbatuese në luftën ndaj tyre, **i dërgoi sot Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një rekomandim për plotësimin e kuadrit rregullator për garantimin e fshehtësisë së votës dhe të një mjedisi të lirë nga intimidimi, të qetë dhe të sigurt për zgjedhësit gjatë ditës së zgjedhjeve⁷.**

Ky akt, i domosdoshëm për tu miratuar si kërkesë e qartë e Kodit Zgjedhor dhe Rekomandimit parësor të ODIHR-it, **në kushtet e ndërveprimit të KQZ-së me Policinë e Shtetit dhe Institucionet e Drejtësisë, do të mundësojë efektivisht largimin e personave të paautorizuar pranë qendrave të votimit, ndalimin e mbajtjes shënim të votuesve, apo të tjera teknikave të përdorura për të evidentuar zgjedhësit që votojnë ose jo, duke zhbërë patronazhimin politik të partive dhe të survejimit të tyre ndaj mënyrës se kur dhe si votojnë qytetarët.**

Ndërkohë lidhur me zhvillimet aktuale lidhur me sa më sipër dhe në nisje të procesit zgjedhor 2025, KRIIK shpreh shqetësimin e tij për një deklaram⁸ të sotëm të

⁶ Shih për shembull:

- KRIIK - [QENDRIM PUBLIK](#) “Qasja proaktive e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve në evidentimin dhe denoncimin e krimit zgjedhor, thelbësor për sigurimin e integritetit të zgjedhjeve dhe të ligjzbatimit në vend”, datë 02.06.2023.

- KRIIK - [QENDRIM PUBLIK](#) “Funksionaliteti i auditit paszgjedhor, si një mekanizëm që konsolidon rolin dhe zhvillimin e përgjegjësive të KQZ-së drejt ligjzbatimit dhe ndëshkimit të politikës cënuese ndaj integritetit të vullnetit të votuesit”, datë 14.12.2023.

⁷ KRIIK – [Rekomandime “Për plotësimin e kuadrit rregullator për garantimin e fshehtësisë së votës dhe të një mjedisi të lirë nga intimidimi, të qetë dhe të sigurt për zgjedhësit gjatë ditës së zgjedhjeve”](#), datë 20.02.2025.

⁸ Gjatë [komunikimit publik](#) në rrjetet sociale Kryeministri dhe kryetari i Partisë Socialiste z. Edi Rama u shpreh se: *“Fatkeqësia është se gabimet e tyre nuk janë si gabimet e ndërmarrjes së gjelbërimit, por kushtojnë jetë njerëzish, trauma dhe plagë psikologjike nganjëherë të riparueshme por nuk ka alternativë tjetër përveç një drejtësie të pavarur profesionale dhe që respekton integritetin, liritë e të drejtat e njeriut. Të pavarurën e kemi para syve, profesionalen duhet të luftojmë së bashku ta konsolidojmë se ka shumë gjëra pozitive por dhe negative. Është betejë për t'u bërë si aleat e partnerë të drejtësisë, pushtete të ndara por të vendosur sepse nuk mund të cenohen të drejtat e pushtetit ekzekutiv. Nuk mund të cenohen të drejtat për të marrë vendime, të trysnohet administrata e shtetit apo të paragjykojen. Dhe nuk mund dot të survejohen partitë politike në një proces elektoral. Uroj të jetë lajthitje e momentit dhe menjëherë të ndalet çdo lloj survejimi në territor. Nuk mund të kthehem në kohërat e errëta që kush merret në politikë të survejohet. Nuk duhet të interferojmë tek njëri-tjetri”*.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Kryeministrit vendit, z. Edi Rama, i cili ka vënë në dyshim legjitimitetin e hetimeve mbi krimet zgjedhore, duke deklaruar se survejimi i partive politike në fushatë është i pajustificuar.

Pa hyrë në atë se çfarë nënkupton Kryeministri i vendit me “survejim të partive politike në fushatë”, në gjykimin e KRIIK, kjo Deklaratë, në vijim edhe të deklaramëve të mëparshme që pas arrestimit të Kryebashkiakut të Tiranës, **përbën një përpjekje të hapur për të ushtruar presion të drejtëpërdrejtë mbi Institucionet e Drejtësisë dhe delegjitimuar veprimtarinë dhe funksionalitetin e tyre**, Institucione këto që kanë detyrimin kushtetues dhe ligjor për të hetuar çdo shkelje të ligjit që cënon integritetin e procesit zgjedhor, pavarësisht nga burimi apo autorët e saj.

Nga ana tjetër, **edhe kryetari i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin z. Fatmir Xhafaj**, në mbledhjen e djeshme të këtij Komisioni, ftoi ekspertët⁹ e Komisionit që drejton që të reflektojnë mbi ndryshime të mundshme për institucionet e pavarura në atë që ai e quajti “mekanizëm që kontrollon kontrollorin”, **një mesazh tjetër intimidues ky dhe i paralajmëruar¹⁰, në gjykimin e KRIIK.**

KRIIK e sheh me vend dhe sjell në vëmendje të gjithë opinionit publik se zgjedhjet e lira dhe të ndershme në vend **nuk mund të sigurohen në një klimë ku Maxhoranca Parlamentare dhe Ekzekutivi përpriqen të ndikojë, intimidojnë apo të kufizojnë veprimtarinë e organeve të pavarura të drejtësisë.**

Çdo përpjekje për të ndërhyrë në punën e institucioneve të drejtësisë apo të institucioneve të pavarura përfaqëson një kërcënim serioz ndaj shtetit të së drejtës dhe minon besimin e qytetarëve tek funksionimi i institucioneve dhe i një shteti ligjor.

KRIIK konsideron tepër të domosdoshme dhe **i bën thirrje të gjithë qytetarëve që të angazhohen në mënyrë aktive në luftën ndaj krimit zgjedhor**, duke investuar mekanizmat që institucionet kanë vendosur apo po vendosin në dispozicion të tyre për të denoncuar¹¹ çdo shkelje që cënon integritetin e zgjedhjeve.

Mediat dhe gazetarët nevojitet që të shtojnë vëmendjen e tyre dhe të raportojnë e t'i japin zë çdo shkeljeje apo rasti të dyshuar të një krimi zgjedhor.

Transparenca e plotë mbi ecurinë e procesit dhe mbi tërë situatën në cilin zhvillohet ai, si dhe bashkëpunimi i gjerë mes të gjithë aktorëve dhe Institucioneve janë elementë kyç për të garantuar **që këto masa të mos mbeten vetëm në letër**, por të shndërrohen në veprime konkrete nga organet kompetente.

⁹ [Mbledhja e Komisionit](#) të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, 19 Shkurt 2025. “(...) Dhe në fund ka një gjë. Kush kontrollon kontrollorin. Një problem që kemi në këtë mekanizëm është se kemi një sërë strukturash investigative, kontrolluese por problemi është aspekti kush i kontrollon këto dhe ku japin llogari dhe se si ne mund ta realizojmë ne këtë gjë. Kjo është një çështje që ka nevojë për reflektim”.

¹⁰ Shih për më shumë [Shkresën Zyrtare të KRIIK, datë 03.04.2024, “OPINION](#) mbi kontekstin politik në vend, në linjë me Rekomandimet e KRIIK mbi procesin e këqyrjes së mëpasshme të fletëve të votimit dhe të materialit zgjedhor të përdorur nga komisionet zgjedhore në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”.

¹¹ Faqja zyrtare e Strukturës së Poaccme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar SPAK – [DENONCO](#) .

Faqja zyrtare e Prokurorisë së Përgjithshme - [DENONCO](#) .

Faqja Zyrtare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve KQZ - [DENONCO](#) .

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Një proces zgjedhor i lirë dhe i ndershëm kërkon një qasje të vendosur nga të gjitha Institucionet dhe një ndëshkim të qartë për ata që përpiqen të deformatojnë vullnetin e qytetarëve, po aq sa **edhe një angazhim të gjithë shoqërisë në refuzimin dhe denoncimin e tyre.**

Në përfundim të kësaj Deklarate, **KRIIK u bën thirrje aktorëve ndërkombëtarë, në veçanti Partnerëve Strategjikë të vendit dhe përfaqësive diplomatike të vendeve europiane partnere të Shqipërisë, si dhe organizatave ndërkombëtare me ekspertizë dhe eksperiencë, që të mbështetin Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Institucionet e Drejtësisë, si edhe Policinë e Shtetit në përmbushjen e detyrimeve ligjore të tyre për forcimin e integriteti të zgjedhjeve, duke u dhënë mbështetje publike përpjekjeve të tyre, si dhe duke u ofruar më tej asistencë teknike apo edhe financiare në mbështetje të veprimtarisë së tyre.**

Tiranë, më 20 Shkurt 2025!

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania